

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët Nesrin Lushta, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Emine Mustafa, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të pandehurve: A.K. dhe A1.K1., për shkak të veprës penale krimi i organizuar (organizimi i një grupi kriminal të organizuar) nga neni 283 par.2 të KPRK-së lidhur me veprën penale detyrimi, nga neni 340 par.2 të KPRK-së, A.N., A.M., M.B., G.Z., K.H., A1.M1., I.M., L.H. dhe A.H., për shkak të veprës penale pjesëmarrja në një grup të organizuar kriminal, nga neni 283 par.1 të KPRK-së lidhur me veprën penale detyrimi, nga neni 340 par.2 të KPRK-së, A.K., A1.K1., R.A dhe G.Z., për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar, nga neni 409 par.1 dhe 5 të KPRK-së dhe veprës penale shtrëngimi, nga neni 195 par.1 dhe 2 të KPRK-së, A.K., A1.K1. dhe A.N., për shkak të veprës penale secili veç e veç mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK-së dhe A.N., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 par.1 i KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, e paraqitur nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.194/2015 të datës 22.11.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.nr.10/2018 të datës 25.1.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 18.6.2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**I.** Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit të Kosovës, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.194/2015 të datës 22.11.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.nr.10/2018 të datës 25.1.2018, në pjesën që ka të bëjë me të pandehurit A.K., A1.K1. dhe A.N..

**II.** Pranohet si e bazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit të Kosovës, **konstatohet** se me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për

Krime të Rënda, PKR.nr.194/2015 të datës 22.11.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.nr.10/2018 të datës 25.1.2018, është shkelur dispozita e nenit 384 par.1 nënpar.1.12 të KPPK-së, në favor të të pandehurve A.M., G.Z., M.B., A1.M1., A.H., K.H., L.H., R.A dhe I.M..

## A r s y e t i m

### **Vendimi i gjykatës së shkallës së parë**

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PKR.nr.194/2015 e datës 22.11.2017, ka hudhur poshtë si të palejuar dhe të parregullt aktakuzën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.107/2012 e datës 3.4.2015 dhe ka pushuar procedurën penale, kundër të pandehurve: A.K. dhe A1.K1., për shkak të veprës penale krimi i organizuar (organizimi i një grupi kriminal të organizuar) nga neni 283 par.2 të KPR-së lidhur me veprën penale detyrimi, nga neni 340 par.2 të KPRK-së, A.N., A.M., M.B., G.Z., K.H., A1.M1., I.M., L.H. dhe A.H., për shkak të veprës penale pjesëmarrja në një grup të organizuar kriminal, nga neni 283 par.1 të KPRK-së lidhur me veprën penale detyrimi, nga neni 340 par.2 të KPRK-së, A.K., A1.K1., R.A dhe G.Z., për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar, nga neni 409 par.1 dhe 5 të KPRK-së dhe veprës penale shtrëngimi, nga neni 195 par.1 dhe 2 të KPRK-së, A.K., A1.K1. dhe A.N., për shkak të veprës penale secili veç e veç mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së dhe A.N., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 par.1 të KPRK-së.

### **Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës**

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN.1.nr.10/2018 e datës 25.1.2018, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

## **Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Kundër këtyre aktvendimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe të konstatohet se aktvendimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal.

Në kërkesë, Prokurori i Shtetit, thekson se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, ka dështuar t'i përmbush kushtet themelore të një vendimi të duhur, duke mos përmbajtur arsyetim elementar dhe duke i munguar interpretimi i thellë i ligjit. Ngjashëm ka vepruar edhe gjykata e shkallës së dytë e cila po ashtu nuk ka bërë shpjegim të mjaftueshëm të bazës ligjore në aktvendimin e saj.

Aktvendimet e kundërshtuara përfaqësojnë një refuzim të drejtpërdrejtë të jurisprudencës së Gjykatës Supreme të Kosovës bazuar në praktikën gjyqësore dhe me këtë rast roli i Gjykatës Supreme të Kosovës, për të zgjidhur konfliktet mes të gjykatave më të ulëta në mungesë të mekanizmit që siguron konsistencë në praktikën gjyqësore është një rol vendimtar për çështjet e rëndësishme dhe me këtë rrit besueshmërinë e publikut.

Më tutje potencohet fakti se koncepti i precedentit nuk është i paraparë me kodet përkatëse e as që të lejohet që një gjykatë e shkallës së parë të hedh poshtë aktvendimin e gjykatës më të lartë dhe atë duke interpretuar rregullat sipas kuptimit subjektiv, që është rrugë e hapur drejt arbitraritetit dhe prolongim të panevojshëm të procedurës penale. Përkundur faktit se mungon sistemi zyrtar i precedentit megjithatë procedura fillimisht zhvillohet në gjykatën e shkallës së parë për të vazhduar me fazën e apelimit në gjykatën e shkallës së dytë, kurse për të përfunduar në Gjykatën Supreme të Kosovës e cila është autoritet përfundimtar dhe njëkohësisht vendimet e saj nuk mund të apelojnë më tutje.

Po ashtu edhe gjykata e shkallës së dytë nuk ka ndërtuar një koncept të precedentit dhe me këtë rast ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe atë në shpërfillje të plotë me

aktvendimet e datës 26.11.2015 të Gjykatës Supreme të Kosovës, në të cilat aktvendime është konstatuar se nëse aktakuza është paraqitur jashtë afatit prej dy vite të përcaktuar sipas dispozitës së nënti 159 par.1 të KPPK-së, kalimi i këtij afati nuk e parandalon prokurorin për të ngritur aktakuzë. Për më tepër në këtë rast është kërkuar vazhdimi i hetimeve i cili nga ana e gjykatës së shkallës së parë është lejuar për një kohëzgjatje prej një muaji, mirëpo gjykata e shkallës së dytë e ka anuluar këtë aktvendim. Ashtu që edhe vonesa nuk ka qenë e madhe por vetëm për disa ditë dhe nuk është bërë për qëllim të keq apo për qëllim të manipulimit.

Më tutje në aktvendimet e kundërshtuara pretendohet se efekti i zgjerimit të hetimeve ndaj të pandehurve të tjerë nuk duhet të ndërlihet me kohën e fillimit të hetimeve për të pandehurit A.K., A1.K1. dhe A.N., sipas aktvendimit fillestar për fillimin e hetimeve të datës 8.3.2015. Në këtë rast afati dy vjeçar nuk mund të vlej për të pandehurit tjerë pasi që ndaj tyre hetimi është zgjeruar bazuar në aktvendimet e më vonshme dhe periudha e hetimit ndryshon varësisht prej aktvendimit për vazhdimin e hetimit për secilin të pandehur dhe nga data e vazhdimin të hetimit për të pandehurit e tjerë duhet të rrjedhë llogaritja e afatit dy vjeçar, pasi që edhe hetimi nuk ka filluar për të gjithë të pandehurit në të njëjtën kohë përkatësisht më datë 8.3.2015.

Gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë nuk kanë paraqitur arsye të plota përkitazi me pretendimet e paraqitura në ankesë se hetimet kanë filluar në të njëjtën kohë për të gjithë të pandehurit më datë 6.3.2015, respektivisht e paraqitur në gjykatën përkatëse më datë 8.3.2015, pasi që vazhdimi i hetimeve ndryshon për të pandehurit e tjerë që vërtetohet sipas aktvendimeve që gjenden në shkresat e lëndës. Po ashtu, pretendohet se të drejtat që u jepen të pandehurve sipas dispozitave të KPPK-së, janë personale dhe nuk mund të transferohen tek njëri-tjetri përkatësisht prej një të pandehuri në tjetrin dhe se vazhdimi i hetimit përkatësisht shtimi i një të pandehuri aktvendimit për fillimin e hetimit duke e zgjeruar hetimin sipas dispozitës së nenit 104 par.1 të KPPK-së, nuk nënkupton se afati të vlejë sipas aktvendimit për fillimin e hetimit përkatësisht i pandehuri ndaj të cilit zgjerohet hetimi të ketë afat më të shkurtër të hetimit.

Edhe pse paraqitësi i kërkesës i referohet shkeljeve të ligjit penal, megjithatë bazuar në elaboratin përkatësisht përshkrimin e kërkesës, rezulton se kemi të bëjmë me shkelje esenciale të

dispozitave të procedurës penale më konkretisht dispozitës së nenit 384 par.1 nënpar.12 të KPPK-së.

### **Mendimi i mbrojtësve të të pandehurve**

Mbrojtësit e të pandehurve nuk janë përgjigjur në pretendimet e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

### **Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës**

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është pjesërisht e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i prokurorit të shtetit, është pjesërisht i bazuar dhe atë:

- aktvendimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa sipas pikës së parë të dispozitivit të këtij aktgjykimi nuk përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as shkelje të ligjit penal për të cilat pretendohet, përkitazi me afatin e paraqitjes së aktakuzës pas kalimit të afatit dy vjeçar pas fillimit të hetimeve;

- shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara janë konstatuar në pikën e dytë të dispozitivit të këtij aktgjykimi përkitazi me efektet e zgjerimit të hetimeve ndaj të pandehurve të tjerë për të cilët është zgjeruar hetimi dhe të cilët nuk kanë qenë të përfshirë në aktvendimin për fillimin e hetimit.

Në rastin konkret nuk rezulton të jetë kontestues fakti se Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka nxjerr aktvendimin e evidentuar PPS.nr.107/2012 të datës 6.3.2013 dhe të konfirmuar se hetimi fillon më datë 8.3.2015, ndaj të pandehurve A.K. dhe A1.K1., për shkak të veprës penale

krimi i organizuar, nga neni 283 par.2 të KPRK-së lidhur me veprën penale detyrimi, nga neni 340 par.2 të KPRK-së, kurse ndaj të pandehurit A.N., për shkak të veprës penale krimi i organizuar, nga neni 283 par.1 të KPRK-së lidhur me veprën penale detyrimi, nga neni 340 par.2 të KPRK-së, si dhe kishte kërkuar nga gjyqtari i procedurës paraprake vazhdimin e hetimeve i cili i ishte lejuar, mirëpo i cili aktvendim ishte anuluar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, kurse aktakuza ishte paraqitur në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda më datë 3.4.2015.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin PKR.nr.194/2015 e datës 30.12.2015, kishte hedhur aktakuzën dhe kishte pushuar procedurën penale për të gjithë të pandehurit, i cili aktvendim është anuluar me aktvendimin PN.nr.87/2016 e datës 25.3.2016 nga Gjykata e Apelit e Kosovës dhe është kthyer në rivendosje. Gjykata e shkallës së parë në rivendosje sipas aktvendimit PKR.nr.194/2015 të datës 22.11.2017, ka hedh aktakuzën dhe ka pushuar procedurën penale i cili aktvendim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit të Kosovës me aktvendimin PN.1.nr.10/2018 të datës 25.1.2018.

Me dispozitën e nenit 159 par.1 të KPPK-së është përcaktuar afati i hetimeve:

*“Kur fillohet hetimi, hetimi përfundon brenda dy (2) viteve. Nëse brenda dy (2) viteve nga fillimi i hetimit paraprak nuk është ngritur aktakuzë, ose nuk është pezulluar hetimi sipas nenit 157 të këtij Kodi, hetimi menjëherë pushohet”,* e që kjo dispozitë qartazi ka përcaktuar afatin ligjor të përfundimit të hetimit brenda dy viteve, përjashtimit nëse pezullohet hetimi e në të cilin rast afati ndalet e që automatikisht nënkuptohet edhe mbyllja e hetimit. Për më tepër, intenca e ligjvënësit është e qartë që prokurori i shtetit t’i ketë në dispozicion afatin dy vjeçar për zhvillim efektiv të hetimeve kurse në raste të ndërlikuara është mundësuar afati për vazhdimin e hetimeve edhe për një periudhë prej gjashtë muaj, siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 159 par.2 të KPPK-së.

Pas fazës së hetimit përkatësisht kalimit të periudhës dy vjeçare nga fillimi i hetimit prokurorit të shtetit i mbesin dy opsione: pushimi i hetimeve apo paraqitja e aktakuzës në raste kur nuk ka pezullim apo vazhdim të hetimeve. Pra, duhet nënkuptuar se afati për paraqitjen e aktakuzës është i ndërlidhur me afatin e hetimeve dhe për më tepër ky është afat ligjor i cili nuk mund të shtyhet në asnjë rast.

Pa mëdyshje se kufizimi i afatit të hetimeve është i arsyeshëm dhe gjithsesi përcakton rregulla të qarta dhe pjesëmarrësit në procedurë penale e kanë të qartë se mospërfillja e këtyre afateve ka pasoja dhe me këtë rast rritet siguria e të pandehurve për një proces të rregullt dhe brenda afateve të limituara dhe me këtë rast kjo dispozitë parandalon arbitraritetin dhe e cenon aspektin themelor të sundimit të ligjit, siç me të drejtë kanë konstatuar në aktvendimet e tyre gjykata e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë.

Sa i përket pretendimit tjetër të paraqitur në kërkesë përkitazi me llogaritjen e afatit ndaj të pandehurve të tjerë për të cilët me aktvendime të veçanta janë zgjeruar hetimet, këto pretendime janë të bazuara. Është e pakontestueshme se fillimisht hetimet janë filluar bazuar në aktvendimin për fillimin e hetimeve të evidentuar PPS.nr.107/2012 të datës 6.3.2013 e që hetimet janë konsideruar të filluara më datë 8.3.2013 dhe atë kundër të pandehurve A.K. dhe A1.K1., për shkak të veprës penale krimi i organizuar, nga neni 283 par.2 të KPRK-së lidhur me veprën penale detyrimi nga neni 340 par.2 të KPRK-së, kurse ndaj të pandehurit A.N., për shkak të veprës penale krimi i organizuar, nga neni 283 par.1 të KPRK-së lidhur me veprën penale detyrimi, nga neni 340 par.2 të KPRK-së. Kurse hetimet për këtë çështje penale janë zgjeruar sipas vendimit PPS.nr.107/2012 të datës 7.10.2013, kundër të pandehurit A.M., për shkak të veprës penale krimi i organizuar, nga neni 283 par.1 të KPRK-së lidhur me veprën penale detyrimi, nga neni 340 par.2 të KPRK-së, ndaj të pandehurve M.B. dhe G.Z., për shkak të veprës penale krimi i organizuar, nga neni 283 par.1 të KPRK-së lidhur me veprën penale detyrimi, nga neni 340 par.2 të KPRK-së, sipas vendimit për zgjerimin e hetimeve PPS.nr.107/2012 të datës 23.10.2013, ndaj të pandehurve A1.M1. dhe A.H., për shkak të veprës penale krimi i organizuar, nga neni 283 par.1 të KPRK-së lidhur me veprën penale detyrimi nga neni 340 par.2 të KPRK-së, sipas vendimit për zgjerimin e hetimeve PPS.nr.107/2012 të datës 27.2.2014, ndaj të pandehurve L.H. dhe A.S., për shkak të veprës penale krimi i organizuar, nga neni 283 par.1 të KPRK-së lidhur me veprën penale detyrimi nga neni 340 par. 2 i KPRK-së, sipas vendimit për zgjerimin e hetimeve PPS.nr.107/2012 të datës 21.3.2014 dhe ndaj të pandehurit K.H., për shkak të veprës penale krimi i organizuar nga neni 283 par.1 të KPRK-së lidhur me veprën penale detyrimi, nga neni 340 par.2 të KPRK-së, sipas vendimit për zgjerimin e hetimeve PPS.nr.107/2012 të datës 16.6.2014.

Janë të bazuara konstatimet e paraqitura në kërkesë se efektet e zgjerimit të hetimeve janë të natyrës personale dhe kanë efekt prej vazhdimit të hetimit për të pandehurit e tjerë dhe në rastin konkret afati prej dy vite për zhvillimin e hetimeve duhet të llogaritet prej aktvendimit për zgjerimin e hetimeve dhe nuk duhet të ndërlihet me aktvendimin fillestar për fillimin e hetimeve.

Gjykata e shkallës së parë në aktvendimin e saj arsyeton vetëm pretendimin përkitazi me afatin e paraqitjes së aktakuzës brenda periudhës dy vjeçare, kurse për pretendimin tjetër për rrjedhjen e afateve për rastet e vazhdimit të hetimeve kundër të pandehurve të tjerë nuk jep arsyetim të qëndrueshëm, përkatësisht paraqet një arsyetim të shkurtër, si në vijim: “... *aktakuza hidhet poshtë sepse ndjekja penale është penguar nga pushimi ex lege i hetimit lidhur me të gjithë të akuzuarit dhe procedura është pushuar ...*” (shih pasusin e dytë faqe 10) dhe për më tepër nuk arsyeton aspektin thelbësor se në rastin konkret a llogaritet vazhdimi i hetimeve përkitazi me të pandehurit e tjerë brenda afatit për fillimin e hetimeve që ishte edhe thelbi i kundërshtimit të paraqitur nga ana e prokurorit të shtetit.

Po ashtu, qasja e ngjashme vërehet edhe në arsyetimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe po ashtu arsyetimi përqendrohet në afatin e paraqitjes së aktakuzës pas kalimit të afatit dy vjeçar të hetimeve, kurse nuk jepet arsyetim përkitazi me pretendimin ankimor për efektin e zgjerimit të hetimeve kundër të pandehurve të tjerë ndaj të cilëve është zgjeruar hetimi në raport me aktvendimin e fillimit të hetimeve. Po ashtu, edhe arsyetimi i gjykatës së shkallës së dytë kësaj çështje mjaft të rëndësishme e përshkruan shkurtimisht “... *nuk qëndron pretendimi i prokurorisë se në rastin konkret afati i hetimeve ka të bëjë për të gjithë të pandehurit pasi që të njëjtit i kanë afatet e njëjta të fillimit të hetimit, për faktin se në rastin konkret hetimet kanë filluar për të gjithë të pandehurit më 6 mars 2013 dhe ndaj të gjithë të akuzuarve është ngritur aktakuza më datën 2.4.2015, kështu që gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur kur ka konsideruar se kjo hedhje e aktakuzës ka të bëjë për të gjithë të pandehurit*”. (pasusi i fundit faqe 6).

Siç mund të konkludohet nga arsyetimi i gjykatës së shkallës së dytë, e njëjta nuk e trajton fare thelbin e problemit për të cilin pretendon prokurori i shtetit. Për më tepër gabimisht konstaton faktin se hetimi ka filluar në të njëjtën kohë për të gjithë të pandehurit që nuk është e qëndrueshme



pasi që qartazi shihet se hetimi fillimisht ka filluar për tre të pandehurit A.K., A1.K1. dhe A.N. dhe i cili hetim gradualisht është zgjeruar ndaj të pandehurve të tjerë dhe atë varësisht prej rrjedhës së procedurës hetimore dhe atë bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve të dëgjuar dhe aplikimi i masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit përkatësisht përgjimeve të komunikimeve mes të pandehurve, por megjithatë mbetet i pakontestueshëm fakti se hetimi për të pandehurit e tjerë ka filluar më vonë.

Gjykata Supreme e Kosovës, vëren se arsyetimet e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë janë të mangëta dhe nuk kanë trajtuar thelbin e materies së pretenduar, andaj me këtë rast thekson se zgjerimi i hetimit në legjislacionin tonë, përkatësisht kodin e procedurës penale është rregulluar me një paragraf të thjeshtë dhe atë me dispozitën e nenit 103 par. 3 të KPPK-së. *“Nëse prokurori i shtetit mëson për kryerjen e një veprë tjetër penale ose për një të dyshuar tjetër gjatë hetimit, mund të fillojë një hetim të ri për veprën e re penale apo të dyshuarit, ose mund të zgjerojë hetimin ekzistues. Prokurori i shtetit njofton gjyqtarin e procedurës paraprake për aktvendimet e reja apo të ndryshuara”*. Nga interpretimi i kësaj dispozite del se kur prokurori i shtetit në rastet pas fillimit të hetimit mëson për të dyshuar të tjerë, ka në diskrecion dy alternativa e para për të filluar hetim të ri apo të zgjerojë hetimin ekzistues siç ka qenë rasti konkret, ashtu që në përputhje me këtë autorizim prokurori i shtetit ka zgjeruar hetimin ndaj të pandehurve të tjerë e filluar kundër tre të pandehurve sipas aktvendimit fillestar për fillim të hetimit.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se vazhdimi i hetimeve ndaj të pandehurve të tjerë për të cilët hetimi ka filluar më vonë dhe atë kundër: A.M., G.Z., M.B., A1.M1., A.H., K.H., L.H., R.A dhe I.M., nuk mund të llogaritet brenda afatit dy vjeçar për përfundimin e hetimit përkatësisht ky afat nuk duhet të jetë afati për përfundim të hetimeve sikurse tek të pandehurit A.K., A1.K1. dhe A.N., ndaj të cilëve më herët është marrë aktvendimi për fillimin e hetimeve.

Po ashtu në arsyetimin e aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të shkallës së dytë, nuk janë paraqitur arsye të qëndrueshme përkitazi me pretendimet e kësaj pike të kundërshtimit përkatësisht të ankesës.

Nga të gjitha këto që u thanë më lart, u vërtetua se për këtë pikë të pretendimit, janë shkelur dispozitat esenciale të procedurës penale në favor të të pandehurve dhe kjo Gjykatë vetëm e konstaton këtë shkelje, duke mos e prekur vendimin e formës së prerë në raport me të pandehurit, siç përcaktohet me nenin 436 par.3 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura, konform dispozitës së nenit 438 par.1 nënpar.1.2 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.130/2018, më datë 18.6.2018

Procesmbajtësi,  
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,  
Nesrin Lushta